



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Nr. 381 Prot.

Vau Dejes, me 20.01.2021

Lenda: Njoftim për mbledhjen e Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Ne mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" neni 53 pika 4 germa a, neni 56 pika 2, neni 57 pika 2 germa c, ju njoftojmë se mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës zhvillohet ditën e Marte me dt. 26.01.2021 ora 14.00. Mbledhja do të zhvillohet bazuar në Aktin Normativ Nr. 3 datë 15.03.2020 i Qeverisë Shqiptare, botuar në Fletoren Zyrtare të R.SH Nr. 37 datë 15.03.2020, neni 5 "Vendimmarrja nga organet kolegjiale" *Marrja e vendimeve nga organet kolegjiale, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19, realizohet edhe nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik. (Mbledhja do të bëhet online me aplikacionin Meet)*

Me këtë rend dite:

1. Projekt Vendim për "Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2021"
2. Projekt Vendim " mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Dhjetorë 2020"
3. Projekt Vendim "Për miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje bari dhe e pyjeve që kulloten"
4. Projekt vendim "për miratimin e listës së ngastrave/nëngastrave të gatshme për dhënie në përdorim"
5. Projekt vendim për rinovim kontrate të dhënies në përdorim me qera të fondit pyjor / kullosor për shfrytëzim kromi Shoqëria "Sokolaj" shpk
6. Projekt vendim për miratim në ngastren nr. 41 c të sipërfaqes prej 300 m² në ekonominë pyjore Shllak I, për ndërtime të përkohshme "Për qender stani e rrethuar, ngrehinë banimi për barinj të dhe stafin"



7. Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat 9 vjeçar të sipërfaqes pyjore prej 0.747 ha në ngastren nr.14 në ekonomine pyjore Drin Gjader Kir për qëllime pushimi, argetimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike, kampingje (kënde lojërash, mjedise sportive, shlodhëse etj).
8. Projekt vendim për miratimin e listës së përfituesve , aplikues në programin “Përmirësimi i kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese deri në një ndertim të ri”
9. Të ndryshme.

Diten e hënë me datë 25.01.2021 do të bëhet mbledhja e komisioneve të këshillit në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Njësia Administrative Bushat ora 9.00 si më poshtë:

1. Komisioni i shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Çeshtjeve gjinore:

- Franga Kola
- Lush Doçi
- Albina Livadhi

2. Komisioni i bujqesise, pyjeve, menaxhimit të ujërave dhe mbrojtjes së mjedisit:

- Agim Sulejmani
- Sulejman Hasmegaj
- Aleko Dodani

**Z/V Kryetari Këshillit
Ervis SHIMAJ**

